



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0448

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Botek SH.P.K, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të K.K. SKENDERAJ në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit 014 - Furnizim me kompjuter dhe laptop për Institucionet e komunës së Skenderajt me numër të prokurimit 643-24-2330-5-5-8, me 10/07/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet** si e bazuar ankesa e OE Botek SH.P.K me nr. 2024/0448 , e datës 23.05.2024, kurse vendimi i AK K.K. SKENDERAJ lidhur me aktivitetin e prokurimit 014 - Furnizim me kompjuter dhe laptop për Institucionet e komunës së Skenderajt me numër të prokurimit 643-24-2330-5-5-8 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Ri -vlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, kurse Ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve sipas 31 paragrafi 6, të Rregullores për Punën e OSHP, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me datë 23.05.2024, OSHP ka pranuar (në sistemin elektronik), ankesë nga OE Botek Sh.P.K., (Protokolli 448/2024) për aktivitetin e prokurimit 014 - Furnizim me kompjuter dhe laptop për Institucionet e komunës së Skenderajt me numër të prokurimit 643-24-2330-5-5-8, i cili është iniciuar nga K.K. SKENDERAJ, nga cilësia e saj si AK.

Me 02.05.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftim lidhur me Vendimin e tij/sajë ku AK ka shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik (OE) INFINITT SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit, i përshkruar si më sipër, ndaj të cilit tani Ankuesi, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim me 07.05.2024, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 13.05.2024.

- Në fazën e shqyrtimit paraprak –

OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrijë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me ketë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 11.06.2024, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa të aprovohet si e bazuar,
- Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli konstatoi paraprakisht se Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Ankuesi është pajtuar me raportin e cituar përderisa AK nuk është pajtuar me raportin e ekspertit. Krahas kësaj konstatohet se palët janë të informuara reciprokisht lidhur me shkresat kësaj lënde (nga platforma e prokurimit elektronik) në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje prandaj ka kushte që

Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesën.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli Shqyrtues konstatoi së pari se, AK ka zbatuar në këtë aktivitet të prokurimit procedurë të hapur, negociuar dhe kufizuar lloji i kontratës: shërbim, punë dhe furnizim dhe veçoi paraprakisht çështjet si në vijim:

(a) AK e ka shpërblyer me kontratë Grupin e Operatorin Ekonomik (OE) INFINITT SH.P.K.

(b) Ankuesi e ka atakuar vendimin e cituar të AK, mes tjerash për faktin se, OE e propozuar për kontratë është e papërgjegjshme sepse nuk i përmbush specifikimet teknike të kërkuara sipas dokumentacionit të tenderit, duke lënë pa u vlerësuar plotësisht dhe korrektësisht ofertat e të gjitha pjesëmarrësve në tender sipas dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores së Prokurimit Publik. Për këto shkaqe AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,28, 59 të LPP-së, si dhe pikën 19 dhe 40 të Rregullores për Prokurim Publik.

Në këtë rast, Paneli mori në konsideratë të gjitha ato fakte dhe prova të cilat trajtohen si të tilla nga pohimet e ankimore, aktet dhe veprimet e AK, analizat e ekspertit shqyrtues, me ç' rast i specifikoi në ato relevante, natyrisht sipas mendimit të tij. Kështu në këtë dosje specifikohen pretendime ankimore të cilat si të tilla janë analizuar dhe nga eksperti. Kështu:

Pretendimet kryesore ankimore sipas ankesës nr.448/24 kanë të bëjnë me OE të rekomanduar për kontratë, i cili sipas OE ankues është i papërgjegjshëm pasi i njëjti nuk ka ofruar informata kyçe të kërkuara si në dosje të tenderit njëjtë ashtu edhe në marrëveshjen kornizë të AQP-së. Informata dhe dokumentet të cilat nuk janë ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, janë deklarata për specifikacion teknik e po ashtu nuk është ofruar as emri prodhuesi, emri modelit dhe specifikacionit teknik. Pas shkarkimit dhe analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, në paramasë kemi gjetur se OE i rekomanduar Infnit, nuk ka shënuar as emrin e prodhuesit, as emrin e modelit me të cilin ofron e as specifikacionin teknik.

Deklarata e ofruar nga OE i rekomanduar se i plotëson specifikat sipas Aneksit 1, për mendim të ekspertit është e pakuptimtë dhe nuk ka kurrfarë vlere përderisa OE nuk ka dhënë informata sipas Aneksit 1 se kush është prodhues, cili model ofertohej, dhe cili është specifikacioni teknik i produkteve që ofron OE i rekomanduar.

Arsyetimi i AK-së në refuzim të kërkesës për rishqyrtim se OE i rekomanduar ka vulosur Aneksin 1-specifikacion teknik, konsiderojmë se është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në kundërshtim me marrëveshjen kornizë UA-2016-23-5755-1-1-1, sepse nuk dihet me cilin prodhues, cilin model dhe cili specifikacion teknik është ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Bazuar në këto që u cekën më lart eksperti ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të bazuara dhe vendimi i AK-së është në kundërshtim me marrëveshjen kornizë dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli analizoi me kujdes edhe pretendimet ankimore dhe pa nevojë që të cekën të gjitha me radhë dhe në mënyrë specifike të përfshihen dhe përshkruhen, konsideron se Raporti i ekspertit shqyrtues përmban hulumtime, analiza dhe profesionale dhe bindëse, sepse secili nga faktet e pohuara nga ankuesi dhe/ose të përfshira në raportin e ekspertizës, është shpjeguar krahas provave bindëse. Ndonëse raporti ekspertizës dhe rekomandimet që i përmban nuk përbejnë detyrim as për palët e as për OSHP-në, në çdo rast Paneli Shqyrtues e vlerësonë dhe analizojnë karakterin e tyre dokumentues, në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të një lënde dhe administrimit të provave.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pasi shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete, diskutimit dhe analizimit të provave në tërësi konsideron se ankesa duke pranuar si e bazuar dhe akti i atakuar dhe veprimet e ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,28, 59 të LPP-së, si dhe pikën 19 dhe 40 të Rregullores për Prokurim Publik, ku konstaton se OE i rekomanduar për kontrate nga AK-ja K.K.Skenderaj nuk i ka përmbushur specifikacionet teknike të detyruara sipas marrëveshjen kornizë UA-2016-23-5755-1-1-1, ku citohet ‘’ për secilin produkte duhet të specifikohet emrin e modelit që e ofertoni. Në kolonën e parë të secilit produkt tek-Prodhuesi - Brand name , duhet të shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të cilin e ofertoni ‘’, duke qartësuar saktë se çka ofertoni, dhe se në ofertë të dorëzuar vetëm është vulosur Aneksi 1 dhe pa asnjë të dhënë tjetër.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i aprovuar në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Paneli vuri si gjithnjë në zbatim edhe nenin 103 të LPP-së sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një subjekti në procedurë.

Duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafi 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, nenin 1, 6 dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lart, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - K.K. SKENDERAJ**
- **OE - Botek shpk**
- Arkivës së OSHP-së: